



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2026

Shtojca 11.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data 06/03/2026.

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE)

X ose

“Deutsche Energie & Technologie” Shpk, me Nuis L51424006O dhe me adrese Prapa ish Bitumit dhe Ish Fushes se Druve me Nr. Pasurie 860/1, Volumi 7, Faqe 78, Zona Kadastrale 3203, Prrrenjas, Elbasan.

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO X

Tipi i Kontratës: Mallra.

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur, mbi kufirin e larte monetar.

Numri i Procedurës /referenca e Lotit: REF-73995-01-16-2026.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje paisje dhe materiale ne kuader te projektit Pro Light Med”.

Kohëzgjatja e kontratës: 30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 19/01/2026.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 7, datë 26 Janar 2026.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori ekonomik “MURATI D” Shpk, me Nuis K42003004T dhe me oferte ekonomike 17,609,560 (shtatembdhjete milion e gjashtëqind e nente mije e peseqind e gjashedhjete) Lek pa TVSH,
OE/BOE me Subjekt Mbështetës:
PO ☐ JO X
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X
- 2- Operatori Ekonomik “M U R A T I” Shpk, me Nuis J66702413V dhe me oferte ekonomike 20,119,270 (njetzet milion e njeqind e nentembdhjete mije e dyqind e shtatedhjete) Lek pa TVSH,
OE/BOE me Subjekt Mbështetës:
PO ☐ JO X
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X
- 3- Operatori Ekonomik “Deutsche Energie & Technologie” Shpk, me Nuis L51424006O dhe me oferte ekonomike 20,766,666.67 (njetzet milion e shtateqind e gjashtedhjete e gjashte mije e gjashtëqind e gjashtedhjete e gjashte pike gjashtedhjete e shtate) Lek pa TVSH,
OE/BOE me Subjekt Mbështetës:
PO ☐ JO X
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Operatori Ekonomik “MURATI D” SH.P.K me Nuis K42003004T,

OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se nuk ploteson kriterin 2.3.1, ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes,

të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara dhe keto fatura të jone të deklaruara në organet tatimore.

ose

b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur faturat tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara dhe keto fatura të jone të deklaruara në organet tatimore”

Theksojmë se për të përmbushur pikën 2.3.1, në lidhje me dëshmitë për përvojën e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, OE duhet të paraqesin dokumentacion për realizimin e furnizimeve të ngjashme me vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

KVO verën se nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se për përmbushjen e këtij kriteri OE ka paraqitur në SPE faturat për furnizime të ngjashme sipas të dhënave të mëposhtme:

Numri i faturës 19/2024, Date 04.06.2024	Bashkia Bulqize	1,788,756 Lek pa TVSH
Numri i faturës 74/2023, Date 26.12.2023	Bashkia Diber	1,205,250 Lek pa TVSH
Numri i faturës 22/2024, Date 02.07.2024	Bashkia Maliq	1,787,840 Lek pa TVSH
Totali i furnizimeve të ngjashme pa TVSH		4,781,846 Lek pa TVSH

Komisioni i Vleresimit të Ofertave thekson se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin furnizime të ngjashme me vlerë prej **9,333,304 Lek pa TVSH** (40% e fondit limit prej 23,333,260), të realizuara brenda 3 viteve nga shpallja e kontratës.

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se operatori ekonomikë ka paraqitur dokumentacion (fatura) për furnizime të ngjashme me vlerë prej 4,781,846 Lek pa TVSH, duke mos vërtetuar realizimin e furnizimeve të ngjashme për një vlerë prej **4,551,458 Lek pa TVSH** për të cilën OE duhet të paraqiste faturat për furnizimet e ngjashme të realizuara brenda tre viteve nga shpallja e kontratës.

KVO thekson se kriteri për furnizimet e ngjashme është një kriter ligjor i parashikuar në nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara”.

Sa me sipër, operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e parashikuara në DST dhe në nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, për eksperiencat e mëparshme të ngjashme dhe ky kriter konsiderohet i papërbushur.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “MURATI D” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “MURATI D” SH.P.K me Nuis K42003004T, skualifikohet.

II. Operatori Ekonomik “M U R A T I” SH.P.K me Nuis J66702413V,

OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se OE:

Se pari, Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se nuk ploteson kriterin 2.3.1, ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara dhe keto fatura të jene të deklaruara në organet tatimore.

ose

b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur faturat tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara dhe keto fatura të jene të deklaruara në organet tatimore”

Theksojme se për te përmbushur pikën 2.3.1, ne lidhje me dëshmitë për përvojën e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, OE duhet të paraqesin dokumentacion për realizimin e furnizimeve të ngjashme me vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

KVO verën se nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se për përmbushjen e këtij kriteri OE ka paraqitur në SPE faturat për furnizime të ngjashme sipas të dhënave të mëposhtme:

-Furnizim i ngjashëm me objekt “Blerje materiale elektrike, hidraulike ndërtimi etj”, me Drejtorinë e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Bashkia Shkoder, me numër reference REF-26908-10-29-2024, me vlerë prej **3,199,820** Lek pa TVSH,

-Furnizim i ngjashëm me objekt "Blerje materiale ndërtimi, elektrike, hidraulike dhe vegla pune për nevojat e Drejtorisë së Shërbimeve Bashkia Polican" me numër reference REF- 41041-03-13-2025, me vlerë prej **1,833,333** Lek pa TVSH,

Po ashtu KVO verën se ky operator ekonomik ka paraqitur dokumentacionin i cili nuk konsiderohet furnizim i ngjashëm me të dhënat si më poshtë vijon:

-Furnizim jo i ngjashëm me objekt: ***“Shpenzime për blerje materiale ndërtimi për nevojat e Bashkisë Polican”*** me numër reference ***REF-96223-02-23-2024***, ku verëhet se ka objekt furnizim të materialeve ndërtimore dhe jo elektrike apo të ngjashme,

-Furnizim jo i ngjashëm me objekt: ***"Blerje bazë materiale për ndërtimin e dy ministacioneve për përmirësimin e teknikave të ujitjes dhe kullimit, skema të reja"*** Bashkia Patos, ku verëhet se ka objekt furnizim të materialeve ndërtimore dhe jo elektrike apo të ngjashme

Komisioni i Vleresimit të Ofertave thekson se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin furnizime të ngjashme me vlerë prej **9,333,304** Lek pa TVSH (40% e fondit limit prej 23,333,260), të realizuara brenda 3 viteve nga shpallja e kontratës.

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se operatorët ekonomikë ka paraqitur dokumentacion për furnizime të ngjashme që konsiderohet i saktë në vlerë prej 5,033,153 Lek pa TVSH, duke mos vertetuar realizimin e furnizimeve të ngjashme për një vlerë prej **4,300,151** Lek pa TVSH për të cilën OE duhet të paraqiste dokumentacion për furnizimet e ngjashme të realizuara brenda tre viteve nga shpallja e kontratës.

KVO thekson se kriteri për furnizimet e ngjashme është një kriter ligjor i parashikuar në nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara”.

Sa me sipër, operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e parashikuara në DST dhe në nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, për eksperiencat e mëparshme të ngjashme dhe ky kriter konsiderohet i papërmbushur.

Se dyti, nuk plotëson kriterin 2.3.7, ku parashikohet se “Ditën dhe orën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Nga 1 (një) mostër për secilin nga artikujt e mëposhtëm:

Nr.	Emertimi
1	Ndricues rrugor 85 w
2	Koke ndricusi urban 41 w
3	Kabull ABC alumini 4X16mm
4	Automat 16A, 1P,
5	Krah shtylle metalike KRH-MSI 1500/1500/10

- *Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave sipas DST-se, pranë magazines se Drejtorisë së shërbimeve Publike, të Bashkisë Lezhë me adresë: Rruga Vellezrit Coku, Ish SMT, Lezhë.*

- **Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.**
- **Mostrat duhet të jene ne përputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara.**

...pasi bazuar ne procesverbalin nr. 03, datë 18.02.2026, i mbajtur midis Komisionit te Vleresimit te ofertave dhe Operatorit Ekonomik “M U R A T I” Shpk, me Nuis J66702413V mbi administrimin e mostrave rezultoi se Mostrat e dorezuara **nuk kane** etiketën të ngjitur, te cilat duhet te kishin te shenuar elementët: mostër **“emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik** dhe per rrjedhoje eshte e pamundur te identifikohen mostrat e dorezuara nga ky OE.

Sa me siper duke qene se Operatori Ekonomik nuk i eshte permbajtur formatit te dorezimit te mostrave ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “M U R A T I” Shpk, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “M U R A T I” Shpk, me Nuis J66702413V, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “Deutsche Energie & Technologie” Shpk, me Nuis L51424006O dhe me adrese Prapa ish Bitumit dhe Ish Fushes se Druve me Nr. Pasurie 860/1, Volumi 7, Faqe 78, Zona Kadastrale 3203, Prrenjas, Elbasan, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 20,766,666.67 (njetzet milion e shtateqind e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtedhjetë e gjashtë pike gjashtedhjetë e shtatë) Lek pa TVSH është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KRYETARI

Pjerin NDREU